AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 2812 Prot.
Datë,më 15. 09. 2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"HOTELERI-TURIZËM" TIRANË

Tiranë, më 11. 09. 2023

Nr. 337 Prot

**Lënda:** Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**
**DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**
**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Udhëzimit Nr 14, datë 27. 05. 2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", i ndryshuar me udhezimin nr..24, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional" Shkolla e mesme profesionale "Hoteleri-Turizëm", Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

**1 (një)** Mësimdhënës të formimit praktik profesional për drejtimin:
" Hoteleri – Turizëm", **me kohë të plotë / specialist kuzhinë - pastiçeri**

1. Kritere të përgjithshme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së, për të cilin/cilat po aplikon;
b) të ketë të ketë te paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

**Dokumentet e aplikimit**

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
   a) letërmotivimin për pozicionin;
   b) jetëshkrimin (CV-në);
   c) kartën e identitetit;
   d) diplomën;
   e) librezën e punës;
   f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
   g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
   h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
   i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
   j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
   k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

2. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e institucionit, brenda datës ...26.09 2023

**DREJTORE**
**Flutura VAQARRI**

Adresa: Rruga e Kavajes 50
Tel/Faks: +355 4 232 0393
e-mail :hoteleriturizem@yahoo.com